

## Thirrje për aplikim për Trajnimin e Trajnerëve (ToT)

### TEMA: “ZHVILLIMI DHE ORGANIZIMI I KOMUNITETIT”

Veprimtaria e organizatave të shoqërisë civile (OShC) krijon hapësirë për angazhimin e qytetarëve përmes fuqizimit të komuniteteve në vendet ku jetojnë. Megjithatë, në të shumtën e rasteve organizatat lidhen ngushtë me përfituesit e tyre, duke mos ndërtuar tërësisht mbi potencialin e angazhimit efektiv të konstituencës. Rrjedhimisht, OShC-të përballen me kufizime si angazhimi joadekuat i konstituencës, mungesa e burimeve dhe njohurive për përfshirje të qytetarëve në punën e tyre, përfshirje e ulët e një game të gjerë të akterëve në çështje lokale, si dhe mungesa e platformave për përfshirjen, pjesëmarrjen dhe angazhimin e qytetarëve në diskutime e vendimmarrje. Angazhimi qytetar dhe pjesëmarrja publike në të shumtën e rasteve vazhdojnë të nxiten nga zhvillimet e jashtme, nuk janë mirë të strukturuar dhe rrjedhimisht nuk janë të qëndrueshme.

Procesi i zhvillimit dhe organizimit të komunitetit krijon mundësi për fuqizimin e komunitetit, krahas përmirësimit të jetës sociale, ekonomike dhe kulturore përmes inkurajimit dhe zhvillimit të individëve për të marrë pjesë në jetë publike dhe proceset e vendimmarrjes. Për më shumë, përafrimi efektiv i OShC-ve me konstituencën rezulton në artikulum më të suksesshëm të perspektivave të përfituesëve, mundësi më të mëdha për shfrytëzimin e burimeve të llojllojshme, qasje dhe komunikim në grupe më të gjera të qytetarëve, si dhe partneritet dhe sigurim të përkrahjes më të madhe nga individë, grupe të organizuara, institucione, biznese dhe akterë të tjerë.

Me qëllim që të adresojë çështjen e zhvillimit dhe organizimit të komunitetit, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), përmes **Programit për Angazhim Qytetar (CEA)** të cilin e zbaton në partneritet me misionin e USAID në Kosovë, **gjatë muajit maj 2023** do të organizojë trajnimin e trajnerëve (ToT) me temën **“Zhvillimi dhe organizimi i komunitetit”**. Trajnimi ka për qëllim të përkrahë OShC-të në zhvillimin e kapaciteteve dhe kompetencave për hartëzimin dhe organizimin e komunitetit, ndërtimin e praktikave për angazhimin e konstituencës, si dhe rrjetëzimin me akterët e tjerë në komunitet.

#### **Roli i trajnerëve**

Trajnerët dhe trajneret të cilët përfundojnë ToT me sukses, do të angazhohen dhe përkrahin OShC-të në zhvillimin e kapaciteteve të brendshme për të angazhuar një gamë të gjerë të akterëve të komunitetit, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e lidhjeve me qytetarët, si dhe krijimin e forumeve për angazhim, pjesëmarrje dhe diskutim. Trajnerët do të përkrahin OShC-të në përvetësimin dhe zbatimin e principeve, funksioneve dhe praktikave për angazhimin aktiv dhe zhvillimin e komunitetit.

Trajnerët do të kenë rol të rëndësishëm në zbatimin e një modeli të kombinuar të mësimin dhe zhvillimit për OShC-të, që do të aplikohet në kuadër të CEA, të përbërë nga:

- Trajnimi mbi Metodologjinë e zhvillimit dhe organizimit të komunitetit;
- Mbështetje dhe mentorim të trajnerëve/eve para dhe pas trajnimit;
- Mentorim për OShC-të në realizimin e punëve praktike të cilat ndihmojnë në përvetësimin e qasjeve dhe metodave për angazhimin e konstituencës në punën e tyre; dhe
- Mentorim për OShC-të në përgatitjen e iniciativave dhe projekteve që adresojnë zhvillimin dhe organizimin e komunitetit dhe këshillim të vazhdueshëm mentorimi.

### **Kush mund të aplikojë dhe cilat janë kriteret e aplikimit?**

Personat me përvojë dhe interesim për zhvillimin dhe organizimin e komuniteti rekomandohen fuqimisht të aplikojnë. Përvoja e mëhershme në procesin e zhvillimit të konstituencës përbrenda shoqërisë civile konsiderohet përparësi. KCSF inkurajon gjithpërfshirje nga aspekti gjinor, i etnisë, përfaqësimit gjeografik nga të gjitha rajonet e Kosovës.

Kandidatët dhe kandidatet për trajnerë/e duhet:

- ✓ Të jenë në dispozicion dhe të përkushtuar për t'u angazhuar si trajnerë/e/ në mentorim të OShC-ve përfituese për zhvillim dhe organizim të komunitetit;
- ✓ Të kenë përvojë dhe interesim për zhvillimet e shoqërisë civile dhe aktivizëm në komunitet;
- ✓ Të kenë përvojë paraprake në angazhime të ngjashme;
- ✓ Të kenë njohuri për rëndësinë dhe teknikat e aktivizimit dhe angazhimit të akterëve të ndryshëm përbrenda komunitetit;
- ✓ Të kenë përvojë në planifikimin dhe organizimin e forumeve dhe diskutimeve me akterë nga sektorë të ndryshëm;
- ✓ Të kenë përvojë në organizimin dhe mbajtjen e trajnimeve apo programeve të edukimit joformal;
- ✓ Të kenë aftësi të shkëlqyera komunikuese (moderim, komunikim, prezantim dhe raportim);
- ✓ Të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze;
- ✓ Të kenë diplomë në nivelin bachelor;
- ✓ Të mos jenë të angazhuar në ndonjë parti politike në katër vitet e fundit.

### **Si të aplikoni?**

Për të marrë pjesë në Trajnimin për Trajnerë (ToT) me temën "Zhvillimi dhe organizimi i komunitetit", të interesuarit dhe të interesuarat duhet të plotësojnë formularin online të aplikimit në vegëzën: <https://bit.ly/3mXluY8>.

Në formular përpos të dhënave që kërkohen duhet të ngarkoni edhe:

- CV-në e detajuar, me fokus në përvojën relevante për temat përkatëse; dhe
- Dëshmi të përvojave të ngjashme (nëse keni).

Formulari i aplikimit mund të plotësohet në gjuhën shqipe ose serbe.

❖ **Afati i fundit për aplikim: 1 maj 2023.**

### **Informata logjistike**

ToT me temën “Zhvillimi dhe mobilizimi i komunitetit” do të mbahet **gjatë muajit maj dhe do të zgjasë tre ditë**. Pjesëmarrësve të përzgjedhur do t'u kërkohet të jenë fizikisht të pranishëm gjatë ditëve të trajnimit, kurse trajnimi do të mbahet në Kosovë. Shpenzimet e transportit dhe akomodimit do të mbulohen nga KCSF. Informata më të hollësishme do t'u dërgohen kandidatëve të suksesshëm përmes ftesës, pas pranimit të tyre në programin e trajnimit.

### **Pritjet nga të certifikuarit e Trajnimit për Trajner/e:**

Trajnerët dhe trajneret e ardhshëm/me pritet të:

- përkrahin OShC-të në Kosovë në zgjerim të konstituencës së tyre, dhe në përgjithësi në rritje të numrit të qytetarëve që përfshihen në punën e tyre;
- të trajnojnë, udhëzojnë dhe mentorojnë iniciativat dhe/ose OShC-të, udhëheqësinë e tyre, stafin, aktivistët dhe/ose vullnetarët që janë përfitues të programit CEA drejt integritit të qasjes për zhvillimin e organizimit e komunitetit dhe aranzhimin e konstituencës në punën e tyre;
- të japin komente, informata kthyesë dhe sugjerime për detyrat praktike të realizuara nga OShC-të (zhvillimi dhe organizimi i komunitetit, angazhimi i konstituencës);
- të japin shpjegime më të thella për OShC-të përfituese rreth koncepteve, qasjeve, metodave dhe teknikave të prezantuara;
- të jenë në gjendje të angazhojnë dhe bashkëpunojnë me akterët dhe grupet e ndryshme përbrenda konstituencës ku OShC-të veprojnë;
- këshillojnë përfituesit në zhvillimin dhe zbatimin e iniciativave për zhvillimin dhe organizimin e komunitetit;
- të mbajnë raporte të rregullta me përfituesit;
- të mbështesin punën përgatitore dhe logjistike të organizimit të trajnimit të OShC-ve për temën e angazhimit të konstituencës.

Pjesëmarrësit e certifikuar në ToT do të bëhen pjesë e grupit të trajnerëve dhe trajnereve për t'u angazhuar në kuadër të mentorimit të OShC-ve në temën e zhvillimit dhe organizimit të komunitetit.

Angazhimi i tyre do të ketë kompensim financiar.

### **Informata më të gjëra për programin dhe trajnimin**

CEA është iniciativë pesë vjeçare që zbatohet nga KCSF në partneritet me misionin e USAID në Kosovë. Qëllimi kryesor i këtij partneriteti është të ushqejë kulturën e aktivizimit që e bën jetën në lagjet dhe qytetet tona më të mirë, më të kujdesshme dhe më kuptimplotë. Nëpërmjet aktiviteteve të tij, programi CEA do të realizojë një numër të veprimeve të bazuara në tre shtylla thelbësore: angazhimin e komunitetit, rritjen e besimit ndër-shoqëror si dhe zgjerimin e mobilizimit e burimeve të reja.

ToT në temën e zhvillimit dhe organizimit të komunitetit për OShC paraqet një nga aktivitetet e shtyllës së parë të CEA, ku do të përfitojnë deri në 20 persona që do të përkrahin dhe mentorojnë OShC-të në integrimin e qasjes së zhvillimit dhe organizimit të komunitetit.

Duke u bazuar në ekspertizën ekzistuese të KCSF-së dhe profesionistëve të fushës, është zhvilluar metodologjia dhe kurrikula që i përshtatet nevojave të OShC-ve bazuar edhe në vet kontributin e OShC-ve. Temat që do të trajtohen gjatë ToT janë paraqitur si më poshtë:

- Qasjet për organizimin dhe zhvillimin e komunitetit;
- Definimi i planit dhe mjetet për zhvillim të komunitetit;
- Metodatat për organizimin e komunitetit;
- Nivelet, metodatat dhe teknikat e angazhimit të konstituencës;
- Teknikat për organizimin e grupeve të veçanta përbrenda konstituencës;
- Përdorimi i teknologjisë për të angazhuar konstituencën.

Pas përfundimit të ToT, stafi i KCSF-së, përmes profesionistëve të fushës, do të ofrojë trajnim dhe monitorim të vazhdueshëm për trajnerët, në mënyrë që të sigurohet edukim i vazhdueshëm cilësor për organizimin dhe zhvillimin e komunitetit.

### **Informata shtesë**

Për informata shtesë ose sqarime të mëtejshme për këtë thirrje, ju lutemi të mos hezitoni të kontaktoni në adresën elektronike: [info@kcsfoundation.org](mailto:info@kcsfoundation.org).